REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 11.01.2023)

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:23 dhe mbaroi në orën 12:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë Juridike.

3. Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Valbona Bala, eksperte (EWMI).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

7. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të Gjykatave të Apelit", i përgatitur nga anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, z.Ilir Rusi, znj. Brikena Ukperaj dhe znj. Marçela Shehu.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e parë për vitin 2023.

Siç jeni në dijeni me rendin e ditës, një nga aktet që Këshilli do marrë në shqyrtim në këtë mbledhje dhe në vijim të akteve të miratuara në mbledhjen e datës 29 dhjetor, është krijimi i Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave të apelit.

Për më shumë detaje i jap fjalën një nga anëtarëve të grupit të punës për hartën gjyqësore, znj. Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Akti i propozuar për miratim ka për qëllim pikërisht krijimin e Komisionit të Ristrukturimit për krijimin dhe funksionimin e gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, i cili do të bazohet në aktet ligjore dhe nënligjore të nxjerra nga ana e Këshillit dhe për aq sa është e mundur, në rregullimet konkrete të ligjit "Për shërbimin civil".

Pas miratimit të rregullave lidhur me strukturën, organigramën, detajimin dhe përshkrimet e punës për nëpunësit gjyqësorë civilë dhe të punësuarit e tjerë në gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga ana e këshillit të kësaj gjykate, në zbatim të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, është miratuar struktura e brendshme e gjykatës së apelit të juridiksionit të përgjithshëm, vendim i marrë nga Këshilli i Gjykatës së Apelit, i është përcjellë KLGJ-së dhe pikërisht, në zbatim të vendimit tonë "Për fillimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit", Këshilli është i detyruar që të marrë masa për ngritjen e këtij komisioni ristrukturimi i cili duhet të fillojë menjëherë punën, me qëllim që në datën 1 shkurt, ne, të kemi sistemimin në pozicione të të gjithë nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë në gjykata të cilat tashmë janë të riorganizuara.

Komisioni i Ristrukturimit ngrihet në bazë të ligjit "Për pushtetin gjyqësor", konkretisht nenin 66, të ligjit 98/2016 dhe përbëhet nga të gjithë kryetarët ose zëvendëskryetarët, pra kryetarët në detyrë në gjykatat e apelit që i nënshtrohen gjithë procesit të riorganizimit të kompetencave tokësore, si dhe kancelarët në detyrë apo nëpunësit e tjerë gjyqësorë të ngarkuar me detyrat e kancelarit sipas vendimit "Për krijimin dhe funksionimin e Komisionit të Ristrukturimit".

Ky Komision Ristrukturimi duhet të drejtohet nga një përfaqësues i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili, ne si grup pune propozojmë të jetë pikërisht kryetari i grupit të punës së hartës, që është edhe zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Rusi.

Pika e parë e projektvendimit përmban pikërisht këtë që unë sapo citova, duke e parashikuar krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave të apelit me përbërje:

- Z. Ilir Rusi – Kryetar (përfaqësues i KLGJ-së);
- Z. {...} – Zëvendëskryetar një Gjykatën e Apelit Durrës;
- Znj. {...} – Zëvendëskryetare e Gjykatës së Apelit Gjirokastër;
- Znj. {...} - Zëvendëskryetare e Gjykatës së Apelit Korçë;
- Z. {...} - Kryetar në detyrë i Gjykatës së Apelit Shkodër;
- Znj. {...} – Kryetare në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë;
- Znj. {...} - Zëvendëskryetare e Gjykatës së Apelit Tiranë.

Ndërkohë, në përbërje të Komisionit të Ristrukturimit janë edhe 6 kancelarët ose në vend të tyre, nëpunësit që kryejnë funksionet e kancelarit, që janë:

- Znj. {...} – Kancelare në Gjykatën e Apelit Durrës;

- Znj. {...} – Kancelare në Gjykatën e Apelit Gjirokastër;

- Znj. {...} – Kancelare në Gjykatën e Apelit Korçë;

- Znj. {...} – Kancelare në Gjykatën e Apelit Vlorë;

- Znj. {...} – Anëtare e këtij Komisioni Ristrukturimi dhe është nëpunëse që ushtron detyrat e Kancelarit në Gjykatën e Apelit Shkodër;

- Znj. {...} – Kancelare në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Pika e dytë e projekt-aktit, parashikon se Komisioni i Ristrukturimit të gjykatave të apelit do të ushtrojnë funksionin pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe do të shqyrtojë mundësinë e sistemimit të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë gjyqësorë të Gjykatave të Apelit Durrës, Gjirokastër, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, të cilët do t'i nënshtrohen ristrukturimit dhe sistemimit të tyre në strukturën dhe organikën e gjykatës pritëse, e cila është Gjykata e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nga 1 shkurti 2023) apo edhe në pozicione të tjera të së njëjtës kategori, në gjykatat e shkallës të para të juridiksionit të përgjithshëm, pasi Këshilli paraprakisht ka marrë masat duke detajuar numrin e të punësuarve dhe duke hapur pozicione të reja edhe në gjykatat e shkallës së parë, me qëllim që humbja e burimeve njerëzore nga ky proces të jetë zero.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, nëse nga kolegët nuk ka diskutim, unë ftoj të kalojmë në miratim projekt-aktin, sipas propozimit të ardhur nga grupi i hartës gjyqësore.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi Krijimin e Komisionit të Ristrukturimit të gjykatave sipas përbërjes edhe sipas rregullimeve të propozuara nga grupi i hartës gjyqësore.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen e sotshme.

Mirë u takofshim!

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor